



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Prishtinë, Datë: 15.01.2013
Nr. 116-25

Fitim Sadiku
Sekretarin e Përgjithshëm
Ministria e Administratës Publike

Lënda: Shkresë Përcjellëse

I nderuar,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) me datë 10.01.2013 ka pranuar një kërkesë nga Lëvizja Vetëvendosje -Rahovec për interpretim ligjor. Kërkesa e Lëvizjes Vetëvendosje ka të bëjë me mandatin e 3 (tre) anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Rahovecit, të cilët në të njëjtën kohë ushtrojnë detyrën edhe të nëpunësit civil në nivel qendror.

Bazuar në shtojcën XI të Rregullores 02/2011 Për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Ministria e Administratës Publike është ministri kompetente për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Ligjit për Administratën Shtetërore, të cilave ligje Lëvizja Vetëvendosje iu është referuar.

Meqenëse Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal nuk është kompetente për dhënien e përgjigjes për kërkesën e lartcekur, ju përcjell këtë lëndë me Nr. 116-25 për përgjigje konkrete.

Bashkangjitur gjeni kërkesën Nr. 116-25 të Lëvizjes Vetëvendosje-Rahovec.


Me respekt,


Besnik Osmani,
Sekretar i Përgjithshëm
Ministrisë së Administrimit të Pushtetit
Lokal

Kopje: Arkivit të MAPL-së

Për: Ministrisë për Administrim të Pushtetit Lokal – Sekretarit të Përhershëm
Këshillit të Pavarur Mbikqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës
Agjencionit Kundër Korrupsionit

CC: Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit
Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë
Kuvendit Komunal në Rahovec
Kryetarit të Komunës së Rahovecit



Nga: Iniciativa Qytetare “Lëvizja VETËVENDOSJE!” – Qendra në Rahovec

Lënda: Kërkesë

Nisur nga fakti se, bërthama e administratës publike është e përbërë nga shërbyesit civil, veprimtaria e të cilëve është e rregulluar me Ligjin për Shërbimin Civil në Kosovë dhe Ligjin për Administratën Publike, shqetësimi qëndron mbi atë se, në Kuvendin Komunal të Rahovecit janë tre delegat të cilët janë duke e shkelur Ligjin për shërbimin civil të Kosovës nr.149, ngase që nga zgjedhjet lokale të vitit 2009 kur e kanë fituar mandatin si delegat, të njëjtit nuk e kanë pezulluar marrëdhënien e punës, siç është paraparë me dispozitat e Ligjit për Shërbimin Civil, neni 89 nënparagrafin 1.3.

Të apostrofuarit janë:

1. Avdullah Kryeziu udhëheqës divizioni në Ministrinë e Tregtisë dhe industrisë dhe njëherit delegat i LDK-së në Kuvendin Komunal të Rahovecit.
2. Burim Krasniqi ekspert në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë dhe njëherit delegate i LDK-së në Kuvendin Komunal të Rahovecit
3. Labinot Berisha zyrtar për mundësi të barabarta në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe njëherit delegate në Kuvendin Komunal të Rahovecit.

Në këtë drejtim, sipas pikës 1 të nenit 17 të Ligjit për Shërbimin Civil të Kosovës në lidhje me nëpunësit civilë të zgjedhur ose të emëruar në detyrë publike jashtë Shërbimit Civil, thuhet se; “Nëpunësit civilë mund të mbajnë, përkohësisht, pozita politike. Gjatë mandatit të tyre në këto pozita, statusi i tyre i nëpunësit civil pezullohet për shkak të mospërputhshmërisë ndërmjet emërimit politik dhe statusit të nëpunësit civil”.

Ne konsiderojmë se mospërputhshmëria mes pozitës së shërbyesit civil dhe të zgjedhurve në cilësinë e këshilltarëve komunal të KK Rahovec, të cilët njëkohësisht kanë të themeluar marrëdhënien e punës në shërbimin civil të Kosovës, paraqet elementet e konfliktit të interesit, e që dispozitat e Ligjit për shërbimin civil pikërisht kanë pasur për qëllim parandalimin e konfliktit të interesit. Duke marr parasysh këtë rrethanë, statusi i dyfishtë i këtyre zyrtarëve përbën vepër të ndëshkueshme sipas ligjeve në fuqi.

Po ashtu, sipas **nenit 89 nënparagrafit 1.3 të LSHCK nr.149** është paraparë pezullimi i marrëdhënies së punës në rastet kur shërbyesi civil ushtron ndonjë funksion publik, e që në këtë rast funksioni publik përfshinë edhe përfaqësimin në kuvendet komunale.

Këta tre nëpunës civil të ministrive të lartë përmendura pos që po e shkelin Ligjin mbi Shërbimin Civil nr. 149 , ata janë duke e dëmtuar edhe buxhetin e Kosovës ngase marrin dy paga të plota edhe si nëpunës civil edhe si delegate –të zgjedhur politik.

Shpresojmë se, në rend të parë Ministria e Pushtetit Lokal, e cila sipas legjislacionit në fuqi është autoritetin mbikëqyrës, dhe Agjensioni Kundër Korrupsionit i cili ka kompetencë ekskluzive për konstatimin e konfliktit të interesit të zyrtarëve të lartpërmendur, t'i ndërmarrin të gjitha veprimet ligjore, në mënyrë që të vihet ligjshmëria në parim.

Data, 10.01.2013 Rahovec

V.V.

